

RELACION TEKNIK

Ndryshimet e paparashikuara në kuader të projektit të miratuar me Vendim KKTKM, Nr.58, datë 12.02.2021 "Revitalizimi dhe Rekualifikimi i Territorit të Ish-Kinostudios "Shqipëria e Re", Parku i Artit"

PRILL 2022

PËRSHKRIM HISTORIK



Foto të vitit 1952

Ndërtesa e Ish Kinostudios “Shqipëria e Re”, është një kompleks ndërtimor me vlera të theksuara arkitektoniko-artistike dhe ambientale. Ky objekt për vlerat që ka, në vitin 2001 është shpallur “Monument Kulture i kategorisë II”.

Kinostudio Shqipëria e Re u themelua në vitin 1952. U ndërtua në periferi të qytetit për arsye që ajo të ishte sa më larg zhurmave si dhe për të pasur hapësira të mjaftueshme edhe për të inskenuar filmime në terrenin e hapur përreth. Në këtë periudhë edhe në Amerikë u formuan cine-city në periferi të qyteteve me hapësira të konsiderueshme. Ndërtimi i Kinostudios shënon dhe ndërtimin e një lagje të re të Tiranës e cila dhe sot mban emrin Kinostudio.

Ndryshimi i sistemit politik dhe kriza ekonomike e viteve '90 sjell transformimin e saj në "Albafilm" dhe në vitin 1996 edhe kjo e fundit mbyll egzistencën e saj. Aktualisht në këtë godinë ushtron aktivitetin e saj Ministria e Kulturës dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.

PËRSHKRIM ARKITEKTONIK

Ndërtesa e ish “Kinostudios Shqiperia e Re”, e vlerësuar si një kompleks ndërtimor, është vendosur në një terren fushor buze rrugës “Aleksander Moisiu” me orjentim nga veri-lindja. Ndërtesa është një nga shfaqjet më të arritura të neoklasicizmit në Shqipëri, i ndërtuar në vitet 1951-1952 dhe i përket periudhës së realizmit socialist.

Projekti është hartuar nga një grup projektuesish sovjetik dhe zbatuar nga ana e specialistëve shqiptarë. Ndërtesa të stilit neo klasik, bashkëkohëse të kompleksit të Ish Kinostudios kemi mjaft në vendin tone. Përdorimi i këtij stili në Shqipëri është i shpjegueshëm për vetë faktin se, ky ka qenë dhe stili mbizotërues në mbare vendet e lindjes ku vendi ynë ishte pjesë politike dhe ideologjike e pandare e sistemit në fjalë.

Korpusi qendror është padyshim pjesa më madhështore e kompleksit ndërtimor ish “Kinostudio Shqiperia e Re”. Kompozicioni simetrik i ndërtësës me portikun qendror, i bazuar në akset simetrike të formave klasike i jep ndërtësës një karakter monumental të qetë. Elementet baze të formulimit arkitektoniko-estetik të tij janë 4 kolonat madhështore me baze rrethore dhe kapitete korintike të zhvilluara në lartësi dy kateshe të korpusit, mbi të cilat mbështetet arkitravi i kornizuar, ku është i vendosur frontoni trekëndor i pasur arkitektonikisht dhe artistikisht me elementet përberës si korniza, frizi dhe elementet skulptural etj.

Faqja ballore e korpusit trajtohet mjaft pasur përse i përket kompozimit të elementeve përberës arkitektoniko-estetik. Në të dy faqet e qosheve të saj, përgjatë gjithë lartësisë janë vendosur dy pilastra me kapitete korintike të cilat me kompozimin e tyre qarkojnë gjithë faqen ballore të korpusit duke i dhënë një monumentalitet. Gjithë korpusi mbështetet mbi një platformë dysheme me pllakë guri e cila lidhet me mjedisin rrethues nepermjet shkallëve të gurta të shpërndara në tre drejtime. Në aksin terthor të zhvillimit planimetrik-volumor të ndërtësës, është i vendosur korpusi qendror i cili dallohet dhe vlerësohet për trajtimin e veçantë planimetrik-volumor dhe arkitektoniko-estetik të elementeve të tij përberës ku ndodhet dhe hyrja kryesore për në ndërtësë.

Në zhvillimin planimetrik kompleksi ka formën e një kryqi me brinjën horizontale mjaft të zgjatur, e vendosur paralel me rrugën dhe brinjën terthore relativisht të shkurter.

Kompleksi ndërtimor ish “Kinostudio Shqiperia e Re”, është një ndërtim dy katesh, me një kat nëntokësor në krahun e djathtë të ndërtësës dhe në pjesën e pasme, me një zhvillim simetrik si në drejtim të shtrirjes planimetrike të dy akseve, ashtu dhe të lartësisë së vëllimeve të korpusëve të ndërtimit.

Në të dy krahët e tij simetrikisht sipas aksit horizontal, janë të vendosur dy korpuset anësore me tërësi në lartësi, ku respektivisht spikasin dy portike ku ndodhen dy hyrje të dyta. Të dy korpuset në pamjen anësore, trajtohen në formën e portikeve, me hyrje të veçanta, të cilat me kalimin e kohës kanë pësuar ndryshime.

Korpusi i pasëm i ndodhur në aksin terthor të ndërtësës, në zhvillimin planimetrik vjen me i zgjeruar nga ai i korpusit qendror me një rritje në lartësi ndaj korpusëve anësore. Në pamjet anësore të tij, ky korpus trajtohet simetrikisht me dy ballkonata në formën e portikeve që korespondojnë me hyrje për në ndërtësë.



NDËHYRJE NDËR VITE:

Ne vitin 1985, objekti ish “Kinostudio Shqiperia e Re” ju nënshtrua një rikonstruksioni të pjeseshëm. Rikonstruksioni preku çatine e cila ishte ndertuar me lende druri dhe për arsye të amortizimit të lëndës paraqiste nevojën e domosdoshme për ndërhyrje. Në mungesë të lëndës së drurit të stazhionuar, rikonstruksioni i çatise u realizua me konstruksion b/a dhe panele b/a, projekt i hartuar nga specialiste shqiptar. Catite e pjeseve të portikeve dhe të hyrjeve të dyta u ribene me konstruksion druri për arsye të vështirësive të realizimit me konstruksion b/a.



Ne vitet 1997/1998, në korpusin e pasëm janë bërë punime, përshtatje të brendshme me krijimin e mjediseve në katin poshtë çatise si dhe punime të karakterit mirembajtës.

Ne vitin 2005-2007 është bërë një ndërhyrje restauruese në korpusin dy katesh të krahut të djathtë ku sot zhvillon aktivitetin e tij, IKTK me punime në brendësi të ndërtesës si dhe punimet e pamjes së jashtme suvatime, dritare, dyer etj.

Në vitin 2013-2014, ndërtesa ju nënshtrua një rikonstruksioni dhe restaurimi tërësor përveç pjesës së mbrapme. E gjithë catija ju nënshtrua rikonstruksionit.

Në vitin 2021, ndërtesa ju nënshtrua restaurimit dhe përshtatjes për ambjentet e “Parkut të Artit”, Loti I-rë duke rikonstruktuar ndërtesën në pjesën e mbrapme të saj si dhe një pjesë të ambienteve të jashtme sistemit të drenazhimit dhe landscape. Ndërkohë projekti do të vijojë me Lotin e II-të.

NEVOJA PËR RESTURIMIN E ÇATISË



Gjatë zbatimit të punimeve të Lotit I-rë u vërejt nevoja për restaurimin e çatisë në pjesën e mbrapme në të cilën nuk është ndërhyrë që prej rikonstruksionit të vitit 1985. Loti I-rë ka kryer punime në pjesën e brendshme por u pa se në disa pjesë të catisë ka rrjedhje dhe nevojë për restaurim të mbulesës së catisë dhe hidroizolim e termoizolim.

Struktura e çatisë në të gjithë gjatësinë e saj paraqet mosvazhdimësi të tipit të materialeve të ndërtimit të saj, kjo situatë me catinë është konfirmuar dhe në pjesën e parme të catisë gjatë restaurimit të vitit 2014. Struktura origjinale ose e një faze më të hershme duket të jetë strukturë me kapriata druri dhe mbulim me tjegulla marseglieze. Nuk mund të thuhet se gjithë struktura e catisë ka kushte optimale për lëvizjen dhe kryerjen e aktiviteteve normale në të, por në këtë projekt-propozim është menduar dhe përpjekur për shfrytëzimin maksimal të sipërfaqes.

Është e paqartë çështja e kuotave dhe nivelimit të paneleve prej betoni dhe pikave të takimit me strukturën e catisë prej druri, për të cilën do bëhet kujdes gjatë fazës së zbatimit të punimeve në praninë e mbikqyrësit të punimeve për nivelimin e saktë të sipërfaqes.

ART PARK
RAPORTI ARKITEKTONIK




Fig – Konstruksioni ekzistues i catise

Në një fazë të mëvonë (1985) është ndërtuar një strukturë e re e mbulimit të catisë me një sistem me trarë të pjerrët betoni dhe kapriata metalike që shkarkojnë në muret perimetralë të godinës dhe muret mbajtës qendrorë.




Fig – Struktura ku mbështetet mbulesa me panele betoni

ART PARK
RAPORTI ARKITEKTONIK

 TRA b/a i pjerret i supozuar

 TRA b/a i pjerret ku mbeshteten soletat e mbulimit të çatisë

 Ashensori

 shina doplo T




Struktura prej druri dhe pikat e takimit të dy strukturave të ndryshme të çatisë paraqesi përgjithësisht problematikat më të mëdha pasi tjegullat mbuluese janë spostuar dhe lejojnë rrjedhjen e ujërave të shiut brenda godinës, gjithashtu ka mungesë të shtresave mbuluese petavra druri dhe shtesë hidroizoluese të cilët do të rivendosen gjatë restaurimit të strukturës së çatisë.



Mbulimi është realizuar me soleta parafabrikatë (të cilat në fugat e tyre lejojnë rrjedhjen e ujërave të shiut) dhe mbi to tjegullat marseglieze. Për përmirësimin e kushteve të ndërtesës duhet marë parasysh hidroizolimi dhe termoizolimi i çatisë dhe si rrjedhojë do restaurohet e gjithë pjesa e mbrapme e çatisë.

Restaurimi i catisë do të marrë në konsideratë:

- çmontimin e tjegullave marseglieze
- pastrimin e sipërfaqes së paneleve prej betoni
- nivelimin me një shtresë llustër cimento për nivelim
- hidroizolim me dy komponent (A+B) me bazë cimento ose letër katrama 4mm
- termoizolim 5cm me densitet maksimal
- listela druri vertikale 4*5 cm cdo 60 cm
- listela druri horizontale 4*5cm sipas përmasave të tjegullave
- mbulim me tjegulla marseglieze (përzgjedhja e tjegullave bëhet në prani të mbikqyrësit të punimeve dhe me miratimin e tij).
- në pjesët e takimit të mbulesës me soletë betoni me konstruksionin e drurit, lidhja bëhet me profil metalik dhe restaurohet konstruksioni i drurit si dhe shtohet shtresa me petavra, më pas hidroizolimi me letër katrama dhe vazhdojnë shtresat e tjera njësoj si tek mbulesa me panele betoni.



Gjithashtu në fasadën e mbrapme:

- do të restaurohet dhe suvatohet kulla/oxhaku suvatim,
- restaurim kornize dhe lyerje fasade

